

VENDIM
Nr. 96, datë 20.4.2018

**MBI FILLIMIN E PROCEDURËS PËR SHQYRTIMIN DHE MIRATIMIN E
RREGULLORES SË VEÇANTË PËR LËSHIMIN, TRANSFERIMIN DHE ANULIMIN E
GARANCIVE TË ORIGINËS**

Në mbështetje të nenit 16, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”; të nenit 16, pika 13, të ligjit nr. 7/2017, “Për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme”, si dhe të nenit 26 të “Rregullave të organizimit dhe të funksionimit të ERE-s”, miratuar me vendimin të bordit të ERE-s, nr. 96, datë 17.6.2016, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 20.4.2018, mbasi shqyrtoi draftin dhe relacionin e përgatitur nga drejtoritë teknike, në lidhje me fillimin e procedurës për shqyrtimin dhe miratimin e “Draftrregullores së veçantë për krijimin e një sistemi të saktë, të besueshëm e të mbrojtur nga abuzimet për lëshimin, transferimin dhe revokimin e garancive të origjinës”,

konstatoi se:

- Neni 16, pika 13, i ligjit nr. 7/2017, “Për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme”, i jep të drejtën ERE-s të miratojë një rregullore të veçantë për krijimin e një sistemi të saktë, të besueshëm e të mbrojtur nga abuzimet për lëshimin, transferimin dhe revokimin e garancive të origjinës.

- Ky draft është hartuar në respektim të parashikimeve të dispozitave të ligjit nr. 7/2017, “Për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme”.

Për gjithë sa më sipër cituar, bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurën për shqyrtimin dhe miratimin e “Rregullores së veçantë për lëshimin, transferimin dhe anulimin e garancive të origjinës”.

2. Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit të njoftojë palët e interesit për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti